



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 72, Datë 26.03.2018

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART WATT” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, germa “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; neni 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për Licencimin e shoqërisë “Smart Watt” shpk, në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Smart Watt” shpk, me shkresën me nr. 137 prot, datë 31.01.2018, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 50, datë 07.03.2018 vendosi: “Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “SMART WATT” shpk ne aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike”.
- Me shkresën nr. 55/10 Prot, datë 09.03.2018 është bërë njoftimi ne median e shkruar lidhur me fillimin e procedurave për licencim të shoqërisë “smart watt” shpk.
- Aplikimi i shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formatit I aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë “Smart Watt” shpk, në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.